

TRANSKRIPTI

Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor

LULZIM ZENELI mund të fillojmë nëse jeni të pajtimit, ju falënderoj për pjesëmarrje në dëgjimin publik i cili organizohet nga Komisioni parlamentar për bujqësi dhe mjedis, për temën për të cilën jeni njoftuar me ftesë projektligji për ndryshim e plotësim të LPH-së, arsyeja pse jemi këtu sot është të dëgjojmë nga përfaqësuesit e komunave opinionin e tyre rreth këtij projektligji dhe a mendojnë se ky projektligj e rregullon këtë problematikë duke pasur parasysh Ligjin e planifikimit Hapësinor të miratuar më parë nga kuvendi, dhe a mendojnë se janë specifikuar sa duhet detyrat që dalin prej këtij projekti. Ne këtu sot jemi ardhë të ju dëgjojmë edhe pse po shohë se numër i vogël të përfaqësuesve të komunave janë ardhë, mirëpo sado që janë për ne janë të mirëseardhur, prandaj pa e zgjatur do t'ju kisha dhënë fjalën të interesuarve, por nëse MMPH ka ndonjë interesim për komentim mund ta marin fjalën, urdhëro z. Zavendës ministër.

MERXHAN ABDYLI përshëndetje të gjithëve veçanërisht ata që kanë ardh nga komunat, edhe pse po shihet se shumë pak kanë ardhë, vetëm tre vetë qenkan këtu, kjo është pasojë e mosorganizimit tonë të brendshëm, LPH është miratuar më 2003 dhe janë vërejt disa mangësi në te, ndaj kjo ministri ka sponsorizua këtë projektligj për ndryshim e plotësim e cila është miratuar me 16 mars nga deputetët e kuvendit, ky ligj sa për MMPH ka mar formën e prerë dhe i ka 19 nene, nëse ka vërejtje nga komunat ky komision do ti procedoi por edhe MMPH do të kontribuoi, kurse për pyetje eventuale jemi të gatshëm të përgjigjemi, faleminderit.

XHELAL LLONÇARI ligjërues në fakultetin e arkitekturës, i kom kqyr këto shkresa që më janë dërguar, pyetjet që janë bërë i kom analizu sikurse edhe herën e parë kur është saju ligji , por e kam një pyetje lidhje me një nen i cili për gjys tentohet këtu të ndrohet por kujtoj se duhet të ndrohet edhe neni bazë, është një paragraf i neni 11 ku shtrohet pyetja sa është arrit nëpër komuna në çështjen e planeve dhe kapërcehet një pyetje se sa është arrit në planin hapësinor, sepse sipas neni 11 ai duhet të jetë përcaktues i planeve komunale, kjo është një dhe e dyta, mendoj se përkufizimi i cili përcakton se dy komuna e më tepër munden të bëjnë plan të përbashkët hapësinor-zhvillimor, ose duhet të fshihet ose të precizohet, pyetja kishte me qenë kështu : a mundet Peja dhe Kamenica të bëjnë plan të përbashkët hapësinor, jo s'munden, ku shkruan në ligj që s'munden, dmth ky nen duhet të shqyrtohet më seriozisht, ose të shkruhet “dy komuna fqinjë me pëlqimin paraprak të ministrisë”, nëse kam kohë unë do të vazhdoi dhe ju lus të koncentrohemi sepse kërkohet që termi “planifikimi urbanistik” të zëvendësohet me “planifikim urban”, në fakt është mirë sepse duhet të jetë “urbanistik”, në gjuhën shqipe shpesh ndodhin disa gabime prej anglishtes, sepse “urban planing” është “planifikim urbanistik” , koncepti “urban” është kategori shoqërore brenda një strukture urbanistike, e këtu po flasim për planifikim urbanistik e jo për planifikim urban, prandaj unë jam që të mbetet planifikim

urbanistik dhe fjala urban kudo të zëvendësohet me urbanistik, pastaj ju lus të më përcillni te pikat e rradhitura 22, 23 etj ku thuhet çka nënkuptohet me plan fillon prej komunës e shkon deri te Kosova, duhet të jetë e kundërta, disa definicione janë absolutikisht të papranueshme sikurse që është ai për fshatin ku thotë se është ai vend ku shumica mirën me bujqësi pra nuk është ashtu, sepse kemi fshatra që nuk mirën me bujqësi, në vazhden e asaj është edhe definicioni i banimeve informate njësoj i papranueshëm sepse thotë “ku popullata nuk ka kushte të mira të jetesës”, nuk është i vetmi dimension ky që e definon vendbanimin informal, ne kemi plot fshatra që nuk i kanë kushtet e mira të jetesës dhe nuk janë vendbanime informale, tash nuk do të merna me definimin e këtyre vendbanimeve por kujtoj se hartuesit duhet të sqarojnë më mirë këto gjëra sepse nuk janë çështje të parëndësishme, sepse do të kemi problem me bashkësinë ndërkombëtare që na ka caktua një standard, gjithashtu edhe definicioni për qytetin nuk është në rregull, edhe “vija rregullative” nuk është në rregull sepse nuk mundet një vi të jet ndarëse e dy koncepteve, vija i ndan dy struktura fizike pra është vijë që ndanë ngastrën e ndërtimit prej hapësirës publike, pra hapësirës jo të drejtës, edhe së fundi kam vërejtje të cilin e ripërsërisë prap , është fjala për “lejen urbanistike” i cili koncept është i paqartë, në aspektin semantik leje urbanistike as që mund të ketë, leja është diçka që tregon se diç është e lejuar e diç jo : lejohet ndërtimi, s’lejohet ndërtimi, lejohet kalimi s’lejohet kalimi etj kurrkush nuk mbaron urbanizëm prandaj nuk lejohet në urbanizëm, mund të jetë pëlqim urbanistik , aprovim urbanistik, zgjidhje urbanistike etj.

RAMADAN KRASNIQI – Prizren më bren se në këtë material nuk ka arsyetim për qasjen e këtyre ndryshimeve që po dëshirohen me u ba, çoftë nga Qeveria çoftë nga Ministria, pra për çfarë po tentohet me këto ndryshime, pse e them këte, e them sepse unë dhe ky kolegu kemi qenë në Ministri të mjedisit kur është hartuar ligji, kemi qenë disa herë edhe në diskutime rreth akteve nënligjore, më duket se janë hartuar 15 akte nënligjore, këto akte nënligjore kanë qenë të mirëseardhura për komunat në lehtësimin e zbatimit të këtij ligji ose ndihmesë për punën e drejtorive komunale, tash e pyes veten pas 4 viteve të kërkohej ndryshime është qudi ngase nuk ka material substancial për këtë qëllim, këtu në p/l më tepër shoh disa arsyetime teknike, p.sh. shkojmë në përkufizime (do tju lodhi pak) , te neni 2 janë shtua disa përkufizime , në rregull jam dakord, pasi që kemi nocion të ri si përkufizim “vendbanimet joformale” LPH-ja këtë gjë nuk e trajton , pra dua të them se ligji atë duhet ta elaboroi e jo ky tani si plotësim i atij ligji, ngase vendbanimet joformale janë shumë karakteristike dhe i përkasin standardit të 6 të caktuar nga bashkësia ndrkombtare mbi drejtën pronësore andaj është dashur të përfshihet zgjidhja e këtij problemi, sepse ne e dimë që këto vendbanime janë të parregulluara, janë lagje të varfëra (banuar nga të varfërit) , lagjet që kanë mbet mbrapa me gjithçka sidomos me infrastrukturë si pasoj e periudhës pas konfliktit në Kosovë kur janë zhvendosur banorët ku kanë mundur etj, intenca ime është që këto të përfshihen me plane më të gjëra të qeverive komunale që kushtëzon edhe planifikimin e buxhetit, këto lagje janë pjesë përbërëse të komunës, komuna është ajo e cila duhet ti qaset rregullimit të tyre-inkorporimin e tyre në planet e ardhshme, mirëpo kjo çështje fare nuk është diskutue në këtë draft. Te neni 4 ku thotë shtohen tri paragrafe por këto më mirë rregullohen me udhëzime administrative se sa me këto tri paragrafe, te neni 5 ky nen që po ndryshohet (7.3) është shumë ma i kjart në ligjin ekzistues se sa tani që propozohet, te neni 6 ky nen që u shtu (8.3) bjen ndesh me udhëzimin administrativ për provim profesional dhe licencimin e tyre, pra këtu nuk po shoh materie substanciale që ndryshohet.

Përfaqësuesi i Drejtorisë së Urbanizmit-Gjilan (diskutimi nuk u incizua) , rezymeja e diskutimit : pajtohem me vërejtjet e cekura sepse projektligji më tepër mirët me çështje teknike. Më elementare është të ndërrohet Ligji për ndërtimin dhe token ndërtimore , ngase më mirë është një ligj të rregulloi këto çështje se sa tri e asnjëra si duhet.

MERXHAN ABDYLI meqë nga pyetjet e parashtruara e pamë se pyetjet janë të adresuara te sponzorizuesi, lus bashkëpunëtorët të japin përgjigje në pyetjet e parashtruara.

Përfaqësuesja nga MMPH (Hydajete) fillimisht falënderoj për pyetjet e parashtruara sepse ato janë një lloj kontributi për kompletimin e ligjit, do të filloja sa i përket pyetjes së z. Krasniqi i cili bëri vërejtje për elaborimin e vendbanimeve i cili tha se ato përmenden vetëm në përkufizime, dua të ju informoj se këto vendbanime përmenden në nenin 22.2 ku thuhet se trajtimi i tyre do të bëhet me plane përkatëse, ju e kërkuat alternativën e rregullimit të këtyre vendbanimeve dhe ne në atë drejtim po punojmë, por nuk na u ka dukur e arsyeshme të japim rëndësi aq të madhe këtyre vendbanimeve sepse ky ligj është vetëm kornizë, nuk detalizon aq tepër, në këtë drejtim është duke u punuar plani afatmesëm dhe afatgjatë, mandej te neni 6 për të cilin z. Ramadan tha se bien ndesh me udhëzimin administrativ, ndaj muj me than se udhëzimi administrativ rrjedh nga ligji i mëhershëm, ndaj ndryshime ka me pas pas miratimit të këtij projekti. Sa i përket definicionit se ka qenë ai i mëparshmi më i mirë, po ju përkujtoi z. Krasniqi se edhe ju jeni pajtuar njëzëri me këtë pasi keni qenë anëtarë i grupit punues se kush mund ti parashtrohet provimit profesional, me ligjin e mëhershëm është thënë se provimit profesional nuk do t'ju nënshtrohen personat që kanë kryer studimet master ose me përgatitje akademike, çka nuk na u ka dok e arsyeshme, pra kështu e ka ndrrue grupi punues dhe ka than se duhet me plotësue kushtin që ti ketë kryer studimet e nevojshme por jo edhe titullin me pas.

VJOSA VELA desha me ju përgjigj diskutuesit të parë kur tha se nuk bënë dy komuna një plan, na kena parapa me këtë ligj për komunat e vogla që kanë interesa të përbashkëta të bëjnë një plan zhvillimor, për shkak të shpenzimeve të panevojshme, edhe komunat (disa) janë pajtuar për këtë, ndryshimi në këtë ligj është se mos të hartohet plani zhvillimor i komunës dhe plani urban bashkërisht sepse p.sh. në Pejë hasëm në probleme, na erdh një dokument, vendimi nuk ishte hartuar sipas ligjit, pra ishte vendimi për dy plane, ne që në start u desht me përmirësue vendimin, pra praktika na mësoi që ta ndrojmë këtë nen-planin zhvillimor komunal të jetë i vetëm, jo bashkërisht me ndonjë komunë tjetër, ndërsa për vendbanime joformale është hartuar udhëzuesi ku janë cekur disa shembuj të këtyre vendbanimeve (tipet), ky udhëzues do të jetë një dokument i mirë për komuna për ti trajtuar këto vendbanime dhe për me i parandalue zhvillimin e tyre, përfaqësuesi nga Prizreni cekti se nuk kemi arsyetim të ligjit , unë e përkujtoi se është memorandum shpjegues ku detalisht gjërat arsyetohen lidhur me këtë ligj. Sa i përket ndryshimeve substanciale po ose jo, muj me thanë, nëse ka ndryshime substanciale atëherë duhet të nxjerret një ligj i ri, çka muj me thanë se edhe këtu kemi ndryshime të tilla , p.sh. sa i përket lejes urbanistike, në ligjin e ndërtimit parashihet për cilat objekte jep leje ministria, tash kemi moskuptime me komunat sepse ata mendojnë se komunat japin lejen urbanistike, por ne mendojm se i njëjti organ që jep lejen ndërtimore e jep edhe lejen urbanistike, mandej fjala ishte për këshillin e ekspertëve dhe u kërkuar se në këtë këshill nuk mundën me qenë personat që kanë hartuar planifikimin hapësinor, kush me qenë atëherë ? , për ate ne kemi propozua që ata që mirën me planin gjegjës të

përfashtohen- të mos jenë anëtar të këshillit në nivel komunal, sa i përket termit urban apo urbanistik në gjatë hartimit të LPH-së kemi has në këto terme, ndaj na u ka dukur mirë urban por nëse është më mirë urbanistik ju jeni për me vendos, përkufizimin për vendbanimet joformale kemi marr nga standardet e Kosovës dhe nga deklarata e Vjenës, sepse vendbanimet joformale kanë disa karakteristika.

XHELAL LLONÇARI po kthehem te çështja e dy komunave a munden një plan me ba, unë fola vetëm për qartësimin e nenit, ju thotë se kemi mendu komunat e vogla etj etj por unë po ju thom ligji kur nuk shkruan atë çka mendoni por flet atë çka keni shkruar, pra nëse thuhet dy komuna duhet të shtohet ose fshihet ose t'voglë edhe me pajtimin e ministrit, kështu e pata fjalën nuk e pata që bon ose s'bon, dy: vendbanimet informale nëse janë mar prej konventës së Vjenës nuk e di por vetëm po them se është i paqëndrueshëm sepse është i përgjithshëm dhe nuk definon vendbanimin informal, sepse me këtë përkufizim 60% e Kosovës ka vendbanime joformale, çka nuk është e vërtetë, pra kjo është ajo dhe duhet kthyer kujdes dy komuna janë dy figura shahu në lojë dhe janë llojllojshme,

Lulzim Zeneli do t'ju kishim dhënë fjalën pak edhe atyre që nuk kanë fol deri tash por sidoqoftë urdhëroni,

Gafur Ilazi-Ferizaj pajtohem me kolegun se vendbanimet joformale nuk është i kështu, te neni 11 (16.6) nuk tregon se si caktohet kjo iniciativë, përmes kuvendit komunal, drejtorisë përkatëse apo si, me urdhër apo me çfarë akti. Te neni 14 pika 27.3 pyes ku do të ankohen palët për lejet që i lëshon ministria.

Vjosa Vela ligji në nenin 15 parasheh (26.4) kundër lejes urbanistike mund të ngritet konflikti administrativ.

Lulzim Zeneli falënderoi për këto sqarime, ja japi fjalën deputetes,

SELVIJE HALIMI faleminderit, unë së pari po jap shqetësimin tim sepse MMPH po e ndryshon këtë ligj me arsyetim se atë e kërkojnë komunat për shkak se disa dispozita janë pengesë, me rastin e leximit të parë kam thënë pse atëherë për këto dispozita nuk është kërkuar ndryshimi i plotësimi, e kuptoj se çdo gjë duhet të evoluoj dhe të ndryshoj, mirëpo unë këtu sot nuk po shohë (bindem) se ligji paska qenë pengesë për kuvendet komunale, zonat e vendbanimeve joformale duhet të fuqizohen përmes ligjit e pastaj të rregullohen konform procedurave tjera, sa i përket lejeve urbanistike që deri tani nuk i kanë lëshuar komunat, duke u nisur nga shpjegimi i profesorit në tani duhet të precizojmë a duhet pëlqim urbanistik apo kushtet tekniko urbanistike apo si, pra po vijmë në përfundim se ky ligj po ndryshon për dy arsye: vendbanimet joformale dhe kontesti mes komunave dhe ministrit sa i përket lejeve urbanistike për objektet me rëndësi të veçantë, nëse komisioni duhet të shqyrtojë edhe çështjen e lejes së dhënies së provimit profesional sepse nuk ka pas dispozita në ligj që kanë peng personat, pra kjo nuk ka qenë dispozitë që ka peng zbatimin e ligjit por dikush është përgjegjës që nuk e ka bërë këtë çështje, duhet ta bëjmë një dallim, nëse kemi studimet master (sistemi i ri i reformave me tri vjet studime), pastaj keni thënë master-magjistër, unë sa di master dhe magjistër nuk janë njësoj, pra duhet të kemi qartë kush janë personat që do të nënshtrohen provimit profesional dhe kush do të licencoi ata, poqëse akademikët i nënshtrohen provimit duhet të dimë se ata do të përgjigjen dikujt, duhet të jetë një komision që do të intervistoi ata, normalisht me një përgatitje më të lartë se ata, pra është një rregull logjik, me ligj disa gjana nuk janë rregullue si duhet, unë kam kërkuar dhe prap po potencoj se ne duhet të kemi vërejtjet

me shkrim të komunave për ndryshime që kërkohen , sepse po du me u bind se a vërtet kan qen dispozitat e LPH pengesë.

Lulzim Zeneli ju kisha lut të jeni të shkurt në pyetjet që kanë shfaqur dilem, sepse na nevojitet kjo për procedurën e rekomandimeve,

Shaban Halimi përshëndes të pranishmit , sidomos përfaqësuesit e komunave të cilët vazhdimisht bashkëpunojnë me institucionet, këto dëgjime publike janë shumë të mirëseardhura për komisionet funksionale, sidomos për këto ligje që janë me shumë interes. Ky ligj ka pengesa për implementim në praktikë, ne kemi kërkuar që komunat të na tregojnë pengesat praktike, mirë kishte me qenë që këto pak komuna që janë të na sjellin me shkrim pas konsultimit se ku janë këto probleme në praktikë, të na sjellin këtu dhe pastaj ne në bashkëpunim me MMPH ti shqyrtojmë ato dhe të amendamentojmë nëse ka nevojë.

Berat Luzha në fillim kisha bërë pyetje edhe MMPH edhe komunave : a ka qenë e nevojshme të ndryshohet dhe plotësohet ky ligj, nëse po atëherë cilat nene, mendoj se një ligj nuk bënë të ndryshoj në 19 nene (tepër është), ose duhet të bëhet një ligj i ri ose të ndryshohen disa nene (2 apo 3 nene), një ligj që ka 38 nene dhe ti ndryshohen 19 nene, kjo është e tepërt, unë spo shohë arsye të mdha për këto ndryshime, megjithëse nuk e di sa është zbatuar ky ligj qe 4 vjet, apo vetëm ka mbet nëpër sirtarë. Definicionet si në këtë projekt ashtu edhe në LPH janë identike, pra mendoj se këto ndryshime nuk janë bërë me seriozitetin e duhur,

Zyhrie Maloku e kundërshtoi sqarimin e përfaqësueses së MMPH rreth vendbanimeve joformale ngase neni 22.2 nuk ka të bëjë me shpjegimin se çka janë ato.

Gazmend Muhaxheri përfaqësuesit komunal për 4 vjet nuk kanë pa të arsyeshme të bëjnë vërejtje për me ndryshue ligjin dhe dihet se ata janë zbatues direkt të ligjit. Pyetja ime është : ku e shohin këta veten në ligj si subjekt të planifikimit hapësinor kur dihet se KK mund të angazhoi dikën tjetër, kur të miraton KK një plan , drejtorisë i mbetet vetëm me zbatu, mirëpo kur atë e bënë dikush tjetër ku po mbeten drejtoritë, pra ku jeni ju si subjekt të ligjit,

Sadudin Berisha kujtoi që një gjë duhet të jetë e qartë sepse një ligj duhet të jetë funksional, edhe në këtë rast kemi vërejtjet e kuvendeve komunale të cilat kërkojnë funksionalitetin e këtij ligji, te ne mungojnë praktikat e hartimit të projektligjeve sepse të gjitha projektligjet përcillen në konventë qofshin ato si ligje apo si ndryshime të ligjeve, normat juridike në projektet e deritanishme nuk përcillen me komente, saktësisht duhet të dihet se cili është interpretimi zyrtar i një norme juridike, mungesa e këtyre komenteve që është në praktikën e legjislaturës moderne bënë që edhe hartuesi mos të jetë i gatshëm për interpretime të një norme juridike por edhe ai që meret me interpretimin e një norme të tillë, unë kujtoj që edhe përkufizimet nuk duhet të jenë pjesë e ligjit ngase ato nuk paraqesin normë juridike (nuk obligojnë), nëse nuk obligojnë ato nuk japin as të drejta e përgjegjësi, ato duhet të jenë pjesa e aneksit të një ligji, për të kuptuar se cila fjalë çfarë kuptimi ka, mos të mendojmë që gjithë ajo që vjen prej Evropës është e mirë (në kuptimin pozitiv po mendoj) , kjo është standardizua nga administrata ndërkombëtare, siç kemi rastin e standardizimit te fillimi i çdo projekti ku thuhet “Në bazë të rregullores...”, rregullorja është akt mbi të cilin fuqizohet një ligj , pra po përfundoj : herave tjera projektligjet duhet të përcillen me komente të cilat nuk do të lejojnë zhargitje të procedurave parlamentare ose implementuese, ndalemi në konceptin e normës, interpretimi zyrtar i sponzorizuesit është ky, tjetër është se çka mendohet, e tjetër çka

shkruhet, unë kam pas raste edhe në komisionet tjera ku eksperti thotë unë kështu e interpretoj, e vërtet është, gjykata e ka një interpretim, por gjykata nuk do të mund të dal jashtë interpretimit të një sponsorizuesi, unë këtë po e them në parim se si do të duhej, mendoj se gjitha ndryshimet të cilat me siguri nuk do të jenë të përkryera, vërejtjet duhet ti përmbledhim dhe së bashku me MMPH ti hyjmë amendamentimit të projektit, kjo ka kalu në leximin e parë, tekniko juridikisht nuk mund të tërhiqet më, as na nuk jemi të interesuar të tërhiqet, por mundësisht ta bëjmë sa më përmbajtësor projektin me këto ndryshime dhe plotësime, faleminderit.

JUSUF SUTAJ përshëndes të pranishmit, unë kam dhënë vërejtje edhe në fillim se ndryshimi i këtij ligji ka ardh në atë formë që në fakt është punu një ligj i ri, aksidentalisht ka kalu në leximin e parë, (reagoi Merxhan Abdyl se është votuar me 75 vota në çka u përgjigj z. Jusuf se nuk do të thotë se vërejtjet nuk përbihen), LPH është aprovu pa planin hapësinor, tani është plani hapësinor por jo i plotë, jam për atë që konceptet dhe definicionet në ligj të jenë të sakta, p.sh. unë e lus profesorin (Llonçari) të na jap një definicion të sakt për vendbanimet joformale sepse më duket se edhe premtoi një gjë të tillë (profesori reagoi se do ta jap me shkrim, jo tani) sepse këtu tanimë janë tri katër versione dhe po del diçka që nuk po e kuptojmë, na kemi kërkuar me shkrim të na sillni vërejtjet por nuk keni sjellë, sepse na i inkorporojmë në ligj, përndryshe kështu nuk mundemi, sepse kjo është një ligj i ri, me pas mendimin e juaj ku e qysh, edhe na bojmë diçka, qishtë nuk amandmohet, ky është ligj i dytë, tash ai i pari a bjen krejt apo çka, sa i përket votimit ne shpesh i votojmë ato (projektligjet) por i votojmë për hirë të ligjit, por pastaj po kemi telashe, ka pas raste që për tet muaj spo mujm me i kry, kaq, faleminderit.

XHELAL CANZIBA kam vërejtje te ndryshimi i nenit 32, se thot para katër vite e kem aprovu një ligj dhe kemi punue 15 akte nënligjore, komunat kan pas afatin 18 muaj me i krye obligimet, komunat nuk i kan kry, edhe ne tash komunave iu japim edhe një 18 muaj tjetër për mi kry detyrat e shtëpisë, do të miremi prap me këtë projekt që thot do ti nxjerrim aktet nënligjore, që do të thot se na nevojiten edhe 2-3 vite tjera, faktikisht po na shkojnë qe 7 vite tuj hartu ligje e ndryshime etj, faleminderit.

LULZIM ZENELI nëse dikush prej deputetëve ose mysafirëve ka mbetur pa thënë diçka ju lus të urdhërojnë apo ndonjë përgjigje eventuale edhe pse nuk jeni të obliguar, urdhëroni po,

VJOSA VELA për vendbanimet joformale po më duket se nuk po dini me i dallu vendbanimet informale prej ndërtimeve ilegale.

SELVIJE HALIMI së pari po e plotësoi kolegun tem për fjalën aksidentalisht, sepse nuk është fjala që aksidentalisht projekti është miratu por e kundërta me vetëdije të plotë, derisa neve na thuhet se komunat kërkojnë ndryshime që të bëhet ligji i zbatueshëm, ne me vetëdije kemi aprovu që të ndryshohet, jo aksidentalisht, flas në emër të GP-PDK, sa i përket se na spo mujna me dallu vendbanimet informale prej ndërtimeve ilegale une nuk e di kush e paraqiti këtë dilem këtu, sepse dy konceptet qartë dallohen, na po dojmë një definicion të qartë, na si Kosovë nuk kemi një dokument ku do të hyjnë definicionet standarde në ligj, derisa se kemi ate po detyrohemi ta bëjmë ma qartë për qytetarët, për ate edhe po i futim përkufizimet në ligj, ma vonë besoj se do ta bëjmë një dokument standard ku do të kemi gjitha shprehjet, unë mendoj se skena meritë me na thonë që spo i dallojmë vendbanimet prej ndërtimeve sepse nuk e shtrum atë dilemë, ne ende nuk kemi një standard (limit) e cila nëse kalohet mund të nxirret një ligj tjetër, pra në mungesë të

standardeve ne duhet ti tolerojmë këto dhe të bëjmë diçka të zbatueshëm, por zbatuesit të ligjit duhet të jenë të përgjegjshëm, faleminderit.

FETAH BERISHA ju kisha drejtuar zonjës së nderuar, nëse ne nuk i dallojmë shprehjet atëherë sqaronani ju të lutem.

JUSUF SUTAJ unë jam i apostrofuar, kërkoja prej profesorit të na jap definicionin për vendbanime joformale, nuk kërkoja prej tjetër kuj, profesori e pranoi , qaq.

LULZIM ZENELI të nderuar gjithë mysafirë të pranishëm ishte kënaqësi që sot t'ju dëgjojmë dhe t'ju marim opinionet e juaja lidhur me këtë projekt, ne duhet ta kemi të qartë se edhe këto ndryshime do ta kalojnë rrugën parlamentare si çdo ligj, dhe besoj se gjitha vërejtjet janë evidentua në transkript dhe procesverbal, të cilat do të na shërbejnë në procedurën e amendamentimit, unë edhe një herë ju falënderoj në bashkëpunim, mirë u pafshim në takimet e radhës, faleminderit.

